



SIGURIA NË SHKOLLA NJË MISION I PAMUNDUR?!



SIGURIA NË SHKOLLA NJË MISION I PAMUNDUR?!



Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ), është organizatë joqeveritare e përqëndruar në sundimin e ligjit që punon për të rritur pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendim-marrëse, për një rajon ballkanik të zhvilluar ku mbretëron paqa dhe drejtësia

Mirënjohje

Ky raport është shkruar nga ekipi i projektit “Siguria në shkolla” në Forumin për Iniciativa Qytetare (FIQ). Falënderojmë Caritasin e Luxemburgut për përkrahjen e çmueshme financiare. Njëherit, falënderojmë të gjithë bashkëpunëtorët, zyrtarët komunal, të arsimit, mësidhënësit, nxënësit, zyrtarët policor, si dhe prindërit nga Komuna e Kaçanikut dhe Hani i Elezit, të cilët me kontributin e tyre bënë të mundur realizimin e këtij projekti.

Përmbajtja

I. Hyrje.....	3
II. Problemet që i përcjellin në vazhdimësi shkollat e mesme.....	4
III. Zhvillimi i projektit në Kaçanik dhe Han të Elezit.....	6
IV. Qasja e përdorur në adresimin e problemeve të identifikuara.....	7
V. Metodologjia e punës.....	7
VI. Puna në Han të Elezit.....	8
VII. Puna në Kaçanik.....	8
VIII. Vendosja e “Kodit të Mirësjelljes” në mure.....	9
IX. Vendosja e ulëseve në oborre të shkollave.....	10
X. Strategjia qeveritare për siguri në shkolla.....	10
XI. Rekomandimet tona për zyrtarët arsimor, qeveritar dhe nxënësit dhe prindërit.....	12

Hyrje

Përmirësimi i sigurisë në shkolla dhe forcimi i ndjenjës së pronësisë qytetare për zgjidhjen e problemeve të sigurisë dhe për të krijuar një mjedis më të sigurt e një sistem më efektiv arsimor, vazhdon të mbetet një ndër angazhimet e vazhdueshme të punës së Forumit për Iniciativa Qytetare.

Që nga viti 2005, FIQ ka zhvilluar disa projekte për të përmirësuar sigurinë në shkollat tona publike dhe atë në shkollat e mesme të Gjilanit dhe Ferizajt, e më pas dhe në tri shkollat e mesme të Prishtinës, të cilat në një hulumtim tonin paraprak, si dhe nga informacioni i përditshëm i dhënë nga mediat dhe institucionet e arsimit dhe ato të sigurisë, ishin identifikuar si shkollat më problematike në kryeqytet.

Për t'u siguruar që shkollat të kenë një Këshill efikas dhe të qëndrueshëm, FIQ ka bërë të mundur krijimin e zyrave të Këshillit të Nxënësve në Gjilan dhe Ferizaj, duke u mundësuar kështu aktivitetet të vazhdueshëm dhe afatgjatë në luftimin dhe parandalimin e incidenteve të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës.

Por, megjithë këto, nuk është parë se është krijuar qëndrueshmëri dhe veprim sistematik institucional për të krijuar mekanizma funksional të forcimit të ambientit të sigurisë në shkolla. Derisa çdo ditë pothuajse lexojmë në kronikat e zeza të shtypit për incidente të ndryshme, siguria në shkollat e mesme të Kosovës vazhdon të mbetet sfidë për komunitetin shkollor dhe institucionet e Kosovës, edhe pse duket se është provuar të ndërmerren hapa nga institucionet qendrore drejt përmirësimit të gjendjes, së paku hapa që kanë prodhuar dokumente strategjike, ndonëse rezultate konkrete nuk janë parë ende.

Problemet që i përcjellin në vazhdimësi shkollat e mesme

Në këto dy komuna janë identifikuar shumë probleme të cilat përcjellin për vite të tëra shkollat e mesme. Problemi i vjetërsisë së objekteve, dëmtimi i inventarit apo mosruajtja e objekteve të reja të ndërtuara nga investimet e huaja dhe nga qeveria, është problem i theksuar kudo në vend. Në Kaçanik, objektet e dy shkollave të mesme janë ndërtuar dekada më parë, janë renovuar gjatë viteve të fundit, por inventari dhe muret e klasës është e pamundur të ruhen për shkak të moskujdesit.

Shkollat nuk mbajnë evidencë për rastet dhe incidentet që ndodhin brenda ambienteve shkollore. Nuk mbahen shënime për masat që janë marrë në rastet kur janë përfshirë organet tjera (p.sh. policia, qendrat spitalore) dhe nuk ka synim të nxjerren mësim nga këto raste për të ndërtuar masa që eliminojnë rastet e ngjashme.

Poashtu, mjedisi shkollor nuk është motivues dhe nuk përmbush kushtet themelore për një nxënie të mësimëve.

“Shkelja e rregullave në shkollë, ngacmimi, rrahjet dhe prania e armëve të ftohta, por edhe e armëve të zjarrit janë të pranishme në Republikën e Kosovës. Analizat kanë treguar se kryerësit e këtyre veprave janë kryesisht të rinj deri në moshën 20 vjeçare. Fakti që ky fenomen është i pranishëm jo vetëm në shkollat e mesme por edhe në shkollat fillore është edhe më alarmues.

Problemi i dhunës apo i sjelljes asociale deri më tani nuk është zgjedhur edhe pse shumë institucione, përfshirë edhe OJQ-të, dhe aktivistë të tjerë janë përpjekur ta trajtojnë këtë çështje.

Mungesa e reagimit të integruar apo e strategjisë shtetërore mund të ketë kontribuar në këtë mangësi.

Gjendja socio-ekonomike në Kosovë nuk duhet të nënvlerësohet si një shkak thelbësor i kësaj gjendjeje. Problemet e grumbulluara brenda familjes shpesh zvogëlojnë rolin e prindërve në edukimin e fëmijëve të tyre. Qendrat për Punë Sociale kanë vështirësi për të monitoruar vazhdimisht fëmijët delikuentë. Disa institucione, deri më tani, kanë treguar interesim të pamjaftueshëm për trajtimin e kësaj çështjeje në mënyrë më të sinkronizuar. Kodi i lejueshmërisë së shikimit (në bazë të moshës) ende nuk është i përcaktuar në Kosovë¹.

Edhe në një hulumtim të organizatës joqeveritare INPO në Ferizaj, e cila ka nxjerrë një raport hulumtues në maj të këtij viti, ndër të tjera përmendet mungesa e pjesëmarrjes së nxënësve në vendimarrje.

“Në bazë të debateve që janë mbajtur, ka dalë që pjesëmarrja e nxënësve në vendimarrje është shumë e ulët. Përveç interesimit të ulët të nxënësve, faktor tjetër është edhe mungesa e mbështetjes nga udhëheqësit e shkollës. Shkaqet janë të shumta por disa prej tyre janë më thelbësore. Arsyeja e parë është qasja burokratike e udhëheqësisë së shkollës ku nxënësi shihet si pranues dhe zbatues i vendimeve, por jo edhe formësues i këtyre vendimeve.

Në fakt, në shumë raste nxënësit dekurajohen në paraqitjen e problemeve. Një problematikë tjetër me të cilin ballafaqohet arsimimi cilësor është funksionalizimi i trekëndëshit shkollë-polici-Qendër për Punë Sociale si dhe nxënës-mësimdhënës-Këshilli i Prindërve. Përkundër ekzistimit të këtyre trekëndëshave, ata nuk janë funksional në mbarëvajtjen e procesit mësimor. Krijimi dhe funksionalizimi i trekëndëshit shkollë-polici-Qendër për Punë Sociale është i domosdoshëm. Kjo domosdoshmëri rrjedh nga problemet e shumta që janë të pranishme në shkollat tona, si manifestimet e dhunshme dhe prirjet ofenduese. Origjina e problemit të mosbashkëpunimit është më shumë subjektive, përkatësisht tek udhëheqësit e këtyre institucioneve, të cilët nuk bashkëpunojnë dhe nuk e shohin të nevojshme të kenë një bashkëpunim të përhershëm dhe të rregullt me qëllim të parandalimit të dukurive të dhunshme. Edhe me rastin e ndodhjes së këtyre dukurive, këto institucione nuk i trajtojnë rastet në mënyrën e duhur ligjore².

Zhvillimi i projektit në Kaçanik dhe Han të Elezit

Projekti “Siguria në shkolla”, në Kaçanik dhe Han të Elezit është zhvilluar nga muaji shkurt deri në tetor të vitit 2009.

Gjimnazi “Skenderbeu”, në Kaçanik ka një numër prej 813 nxënësish. Secila klasë ka më së shumti 41 nxënës, një numër ky i madh që pamundëson ushtrimin e duhur të procesit mësimor.

Shkolla e mesme profesionale “Feriz Guri dhe Vëllezërit Caka”, ka afro 1100 nxënës.

Ndërsa, gjimnazi “Dardania” në Han të Elezit ka 458 nxënës, ku karakteristikë për këtë shkollë është se mësimi zhvillohet vetëm në një ndërrim (paradite), që mundëson ushtrim më efikas të procesit mësimor dhe krijon mundësi për aktivitete të lira.

¹Strategjia për sigurinë në shkolla 2009 – 2011 “Shkollat – një vend i sigurt!” - MPB-MASHT, mars 2009

²Promovimi i Arsimimit Cilësor në komunën e Ferizajt, INPO, maj 2009

Projekti është mbështetur financiarisht nga Caritasi i Luxemburgut, i cili në rajonin e Ferizajt dhe Gjilanit, duke përfshirë pra Kaçanikun dhe Hanin e Elezit, ka punuar në disa sektorë, përfshirë edhe atë për edukim, duke ndihmuar dhe mbështetur komunitetet në nevoja, sidomos nxënësit në nëvojë nga viset rurale me bursa për shkollim.

Debatet e para u organizuan në Kaçanik në fillim të shkurtit, ndaras me nxënësit e gjimnazit “Skenderbeu” dhe me nxënësit e shkollës së mesme profesionale “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”. Nxënësit kishin diskutuar për një mori problemesh të ndryshme që preknin aspekte të sigurisë, por edhe të kualitetit të mësimit dhe çështje tjera, si: mungesa e bashkëpunimit nxënës-prindër-shkollë, mosmbajtja e orës së kujdestarisë, mos-mbajtja e uniformës dhe mungesa e kartelave identifikuese, përdorimi i uniformës së njëjtë për të dyja shkollat, mungesa e ndriçimit në oborrin e shkollës, konflikte, incidente ndërmjet nxënësve dhe poashtu ndërmjet nxënësve dhe personave të tretë joxhënës në oborrin e shkollës dhe në shkollë, kujdestaria ditore jo efektive, moskontrollimi dhe mosidentifikimi i nxënësve dhe personave që hyjnë në shkollë, konflikte nxënës-profesorë, mosrespektimi dhe moszbatimi i rregullores dhe masave ndëshkuese të parapara, mungesa e inventarit dhe demolimi i tij, mungesa e infrastrukturës përcjellëse dhe shkatërrimi i infrastrukturës poseduese, vjedhja e ditarëve shkollor, konsumimi i duhanit në shkollë dhe klasë, kriteri jo i duhur për notim dhe vlerësim të nxënësit, fyerje, paragjykime, dallime ndërmjet nxënësve, mosorganizimi dhe përgatitja e orës në mënyrë profesionale dhe efikase nga ana e mësimitdhënësve.

Mëpastaj, janë organizuar takime njoftuese me institucione komunale, përfshirë drejtues të pushtetit komunal, përgjegjës të arsimit, drejtorët e shkollave dhe me policinë. Në këto takime, është prezentuar natyra dhe qëllimi i projektit dhe përvoja e FIQ-it për të mbështetur sektorin e arsimit në aspektin e sigurisë.

Qasja e përdorur në adresimin e problemeve të identifikuara

Në takimet me Këshillat, njëri ndër problemet më me prioritet është parë mungesa e komunikimit ndërmjet prindërve, nxënësve dhe arsimtarëve të tyre. Për të nxitur pjesëmarrjen e tyre, drejtorët e shkollave kanë pohuar se kanë provuar shpesh të organizojnë takime të ndara me prindër në grupë të vogla, ku secili mësimitdhënës kujdestar ka ftuar prindërit e klasës së tij. Por, niveli i ulët i pjesëmarrjes së prindërve ka ndikuar që ky komunikim të jetë i zbehtë. Për të nxitur përgjegjësinë qytetare, ne bashkë me Këshillat provuam që ta rikthejmë në agjendë të shkollave tërheqjen e vëmendjes së prindërve, duke organizuar kështu debete publike me prindër dhe qytetarë në fillim të vitit shkollor.

Metodologjia e punës

Duke u bazuar në përvojën paraprake në projekte të ngjashme, FIQ ka praktikuar të njëjtën metodologji të punës që është e përafërt me qasjen e përgjithshme të sigurisë në komunitet. FIQ në këto shkolla, kryesisht ka funksionuar Këshilline Shkollës si organi më i lartë vendimmarrës në shkollë. Anëtarë të Këshillit të Shkollës, prindër, mësimitdhënës dhe nxënës janë ftuar për t'ju bashkuar Këshillit, i cili ka qenë pjesë aktive e zbatimit të projektit.

Në takimet (tryeza) e para janë diskutuar problemet që nxënësit kanë identifikuar në debatet paraprake. Është vërejtur si edhe më parë në projekte të ngjashme në komuna të tjera, se perceptimi për problemet dallon kur bëhet fjalë për mësimdhënësit dhe nxënësit.

Derisa nxënësit thërrasin për liri të mëtejme në qasjen e përgjithshme ndaj tyre, mësimdhënësit ankohen se shumë veprime të cilat janë reflektuar nga koncepti i reformave, e kanë thyer respektin për shkollën si institucion edukativ dhe arsimor, duke bërë që nxënësit të përfitojnë liri të tepruara dhe duke e kthyer shkollën në qendër të problemeve.

Duke bashkëpunuar me zyrtarët komunal, Drejtorinë Komunale të Arsimit, drejtorët e shkollave të mesme, anëtarët e Këshillit të Prindërve, mësimdhënësit dhe nxënësit, ne kemi formuar Këshillet e Sigurisë së Shkollave si grupe joformale në kuadër të projektit. Këto Këshille më pas në takimet e tyre të rregullta kanë bërë listën e problemeve më prioritare për të cilat është vlerësuar se kemi kapacitete dhe mundësi për t'i trajtuar dhe zgjidhur.

Kështu, Këshilli është takuar rregullisht gjatë një periudhe tetë mujore, për të diskutuar rreth këtyre problemeve dhe për të gjetur zgjidhje të mundshme për secilin prej tyre.

Puna në Han të Elezit

Më 22 shtator 2009, në sallën e Shtëpisë së Kulturës në Han të Elezit, u mbajt një debat për të adresuar këtë problem. Debatu kishte si temë sigurinë në shkolla, ku të ftuar në panel ishin drejtori i shkollës së mesme "Dardania", Emrush Dërnjani, nënkryetari i komunës, Menduh Vlasi dhe drejtor i Drejtorisë së Arsimit, Mehmet Ballazhi. Në debat morën pjesë afro 40 prindër, që u konsiderua si numër i vogël në krahasim me numrin e nxënësve, ndonëse ftesat u ishin dërguar në shtëpi veçanërisht secilit prind.

Panelistët thekuan hapur se prindërit duhet të rrisin praninë e tyre në jetën shkollore, jo vetëm sa për t'i vizituar fëmijët e tyre, por edhe të mbështesin arsimtarët në aktivitete të ndryshme që shkolla mund të organizojë. Prindërit duhet të bëhen pjesë e zgjidhjes së problemeve dhe duhet të kontribuojnë në çfarëdo mënyre që ata mundën në bazë të përvojës dhe aftësive të tyre.

Këshilli në Han të Elezit kishte adresuar një listë më të shkurtër të problemeve. Nga anëtarë të Këshillit ishin diskutuar edhe metoda dhe forma që janë përdorë në disa komuna tjera, siç është ideja e vendosjes së kamerave në korridore dhe në oborr të shkollës, me idenë që sa më lehtë të bëhet kontrollimi i nxënësve, dhe të regjistrohet hyrja dhe dalja e tyre. Ky debat ishte transmetuar në një kanal informativ përmes rrjetit kabllor që përcillet në këtë komunë.

Puna në Kaçanik

Jo pak probleme ishin hequr nga lista e gjatë gjatë takimeve të rregullta të Këshillit, sepse shpesh ato probleme na dërgonin në adresa të tjera. Në fakt, shumëçka ka dëshmuar se përqëndrimin strategjik në politikat dhe strategjitë kombëtare duhet ta bëjë pushteti qendror, sepse problemet e shumta në arsim nuk mund të zgjidhen nga nivelet lokale. Mungesa e kushteve për punë, mjeteve buxhetore, hapësirës së mjaftueshme shkollore, pagat e ulëta, mungesa e presionit nga niveli qendror për të respektuar edhe ato rregullore dhe vendime të nxjerra, kanë qenë disa nga faktorët që janë konsideruar se kanë mbajtur gjendjen e veprimit stihik dhe pasiv të nivelit lokal të autoriteteve të arsimit.

Më 25 shtator në Shtëpinë e Kulturës në Kaçanik, poashtu u mbajt debati publik me temën "Bashkëpunimi prindër-shkollë-nxënës për problemet në shkollat e mesme".

Në këtë debat ishin të ftuar prindërit e dy shkollave të mesme, nxënës, arsimtarë, përfaqësues nga Drejtoria e Arsimit dhe zyrtarë të pushtetit komunal. Në panel, drejtori i Gjimnazit “Skenderbeu”, Ibush Vishi, drejtori i shkollës së mesme profesionale “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”, Bafti Loku, nxënëset Kaltrina Luta dhe Teuta Malësiu kishin udhëhequr debatin me afro 200 pjesëmarrës, me një prezencë të konsiderueshme të prindërve, por me një numër më të madh nxënësish. Ky debat ishte përcjellur dhe transmetuar nga TV “Tema” në Ferizaj, duke mundësuar kështu përcjelljen e tij edhe nga prindërit e painteresuar, që atë ditë nuk kishin patur mundësi të marrin pjesë.

Debati kishte sjellë shumë diskutime për temën, por edhe për shumë çështje tjera, për të cilat u pa se kishte ekzistuar nevoja që të debatohen publikisht.

Mungesa e teksteve, largimi i nxënësve nga ora për mungesë të mjeteve mësimore, papastërtia në shkollë, përdorimi i telefonave mobil nga mësuesit, u përmendën poashtu si çështje nga nxënësit. Ndërsa mungesa e disiplinës, dëmtimi dhe shkatërrimi i inventarit, mosinteresimi i prindërve ishin përmendur nga drejtorët panelistë. Ndërkaq në takime të rregullta, Këshilli kishte përmendur nevojën që kanë shkollat për roje gjatë natës me qëllim të mbrojtjes së shkollës nga vjedhjet dhe incidentet e mundshme. Por, ata ishin të vetëdijshëm se politika e ministrisë për të zvogëluar apo për të mos rritur numrin e të punësuarve, do ta bëjë të pamundur shtimin e kërkesave për personel. Madje, shumë shkollë në vend kanë humbur pedagogët, punëtorët teknik, apo nuk kanë mundur të angazhojnë psikologë në kuadër të restriksioneve që janë vënë për numrin e personelit të punësuar.

U diskutua poashtu për idenë që në fillim të vitit të ri shkollor të kushtëzohet regjistrimi i nxënësve me prezencën (përcjelljen) e prindërve në shkollë. Për këtë qëllim, FIQ kishte mbështetur Këshillin e projektit në Kaçanik që të hartoj një rregullore ku parashihej sesi të rivendosej lidhja e shkollës me prindërit. Përmes aktit të regjistrimit, mundësohej kështu që prindi të njihet me rregullat e shkollës, me të drejtat dhe obligimet e nxënësit, ndërsa shkollë të merrte kontaktet e prindit përmes një formulari të veçantë, si dhe të merrej zotimi i prindit përmes një deklaratë të nëshkruar, ku ai do të zotohej për të qenë aktiv në organizimet dhe takimet e shkollës, si dhe mbështetjen e punës së Këshillit të Prindërve, me theks të veçantë duke kontribuar në disiplinën e nxënësve në shkollë. Qëllimi i pjesëmarrjes së prindit gjatë regjistrimit të nxënësit është vënia e kontaktit dhe bashkëpunimit direkt të shkollës me prindin, për të siguruar kështu komunikimin e vazhdueshëm gjatë kohës derisa fëmiju i tij/saj ndjek mësimin në këtë shkollë. Këto qëllime përfshijnë marrjen e njohurive për mënyrën e funksionimit të procesit edukativo-arsimor, obligimet, të drejtat dhe detyrimet që ka çdo nxënës konform Kodit të Mirësjelljes. Poashtu, është parapar marrja e obligimeve nga prindi për të komunikuar rregullisht me shkollën, veçanarisht me mësuesit për të kontribuar në sigurinë e nxënësve në shkollë, në ruajtjen e pasurisë së shkollës, disiplinën e përgjithshme të nxënësit dhe është paraparë të ofroj gatishmërinë për të marrë pjesë në të gjitha takimet, forumet që shkollë i thërret dhe organizon duke dëshmuar edhe vetëiniciativë.

Kjo rregullore është dërguar në Drejtori të Arsimit për t'u siguruar se nuk bjen ndesh me rregullat shkollore, ndërsa miratimi i saj eventual nuk është proceduar, për shkak se tashmë viti shkollor kishte filluar dhe regjistrimet ishin kryer. Por, kjo rregullore ishte parë e mundur që të shqyrtohet për zbatim vitin vijues shkollor.

Meqë një nga kërkesat e Këshillit ishte pajisja e shkollës me emblemën e vet identifikuese, FIQ ka ndihmuar dy shkollat e mesme në Kaçanik për të hapur një konkurs publik për përzgjedhjen e emblemës së shkollës, ku do të mund të konkurronin me punime vetëm nxënësit e po atyre shkollave.

Mungesa e emblemës në shkolla ishte vlerësuar problem, pasi uniformat e njëjta i mbanin nxënësit e dy shkollave, dhe ata shpesh lëvizin nga njëra shkollë tek tjetra, që në raste të shpeshta ndikon në prishjen e rendit, pa u vërejtur se kush (nxënësi i cilës shkollë) e bënte këtë. Dy punime ishin pranuar në zyret e drejtorëve, pas një konkursi të hapur trejavor, dhe Këshilli është mbledhur dhe ka miratuar ato punime, të cilat menjëherë janë aprovuar nga Drejtoria e Arsimit dhe të njëjtat emblema janë shtypur në uniformat e reja që shkollat po përgatitnin në kuadër të planeve të veta.

Vendosja e „Kodit të Mirësjelljes“ në mure

“Kodi i Mirësjelljes dhe masat disiplinore për nxënësit e shkollave të mesme“ është një udhëzim administrativ i nxjerrë nga Ministria e Arsimit (MASHT) për së dyti herë në pranverë të këtij viti. Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë të drejtat, obligimet, veprimet e ndaluara, vijueshmërinë në mësim dhe masat e procedurat disiplinore dhe zbatimin e tyre ndaj nxënësve të cilët i shkelin rregullat e kodit të mirësjelljes.

Është vërejtur qartë se ky dokument nuk gjen zbatueshmëri as për së afërmi në këto shkolla, prandaj me kërkesë të nxënësve ky dokument është futur në kornizë dhe është vendosur në të gjitha klasët dhe korridoret e shkollës.

Vendosja e ulëseve në oborre të shkollave

Që në fillim të projektit, FIQ kishte planifikuar një fond prej 4 mijë eurosh për të mbështetur ndonjë kërkesë eventuale të shkollave që do të mundësonte shtimin e sigurisë. Gjatë punës me Këshillat, në të dyja qytetet, ata kishin kërkuar që të bliheshin ulëse për nxënësit, e që do të vendoseshin në oborre. Kështu, janë blerë nga 13 ulëse për dy shkollat në Kaçanik dhe 11 të tjera për gjimnazin në Han të Elezit.

Strategjia qeveritare për siguri në shkolla

Gjatë vitit 2008, Ministria e Punëve të Brendshme dhe ajo e Arsimit të mbështetura edhe nga organizata ndërkombëtare këtu në Kosovë, patën filluar punën në hartimin e strategjisë kombëtare për siguri në shkolla, e cila sot e kësaj dite nuk duket askund në horizont. Strategjia, jo vetëm që nuk është në zbatim, por ajo duket të mos jetë përfunduar fare. Tani bëhen më shumë se një vit, që kur puna në të kishte filluar, e për të cilën ishin shpenzuar mjaft të holla, por që fatëkeqësisht, gjendja në shkollat publike ka mbetur e njëjtë sa i përket sigurisë, madje në disa shkolla të kryeqytetit ajo është përkeqësuar.

Ishte bërë publike se në prill të këtij viti, MASHT dhe MPB kishin prezantuar draft-dokumentin “Strategjia për siguri në shkolla 2009-2011 - Shkolla një vend i sigurt”, por që nga atëherë nuk ka ndonjë konfirmim nga Qeveria nëse një strategji e tillë është miratuar apo jo. Për më shumë, ky dokument nuk mund të gjindet fare në asnjë nga faqet zyrtare të ministrive të lartëpërmendura, madje ai dokument nuk është bërë kurrë publik. Ndër objektivat kryesore të këtij dokumenti (strategjie), të cilin FIQ e ka siguruar janë:

SIGURIA NË SHKOLLA - NJË MISION I PAMUNDUR?!

Krijimi i kornizës dhe partneritete të nevojshme institucionale për zbatim dhe monitorim të strategjisë në shkolla


Rritja e kapaciteteve të të gjitha palëve të përfshira

Parandalimi i incidenteve dhe sjelljeve asociale, viktimizimi në mesin e të rinjve, dhe të zvogëlohet numri i incidenteve në shkolla

Të mbrojtë komunitetin e shkollës përmes të cilit përmirësohet mjedisi i mësimnxënies

Të reagohet në mënyrë të duhur në rast të incidenteve.

Në këtë dokument, kështu ishte paraqitur analiza e gjendjes:



Në këtë dokument qeveritar, thuhet se “parimet bazë për suksesin e strategjisë për sigurinë në shkolla dhe të planit të veprimit janë”:

- Themelimi i grupit drejtues strategjik që do të përbëhet nga Ministri i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndihmësdrejtori i Policisë së Kosovës (Shtylla e operacioneve), Ministri i Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.
- Drejtuesit Strategjikë delegojnë përfaqësues për të krijuar grupet për menaxhim, vlerësim dhe raportim për grupin drejtues strategjik;
- Krijimi i protokolleve mes agjencive të ndryshme të përfshira (Ministria e Punëve të Brendshme – Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, Policia e Kosovës – drejtorët e shkollave, dhe mes ministrive të ndryshme, siç është Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për politika të përbashkëta në fushën e parandalimit, mbrojtjes dhe reagimit dhe sipas nevojës;
- Programet për sigurinë në shkolla të bëhen pjesë e sinkronizuar e strategjisë së përgjithshme të sigurisë në komunitet;
- Punësimi dhe përzgjedhja efektive e profesionistëve në shkolla (pedagogëve, etj) dhe e policëve që do të përkrahin programin për parandalimin e dhunës në shkolla;
- Zbatimi i vlerësimit për sigurinë në shkolla nga të gjithë drejtorët e shkollave që mund të përdoret si analizë SWOT në nivel lokal;
- Themelimi dhe funksionimi, në vendet ku nuk ekzistojnë, i këshillave të shkollës që do të përbëheshin sipas ligjeve relevante nga punonjësit e shkollës (mësimdhënësit, drejtorët), përfaqësuesit e nxënësve dhe prindërve;
- Përcaktimi i përgjegjësive për të gjitha palët e përfshira me interes;
- Përcaktimi i kanaleve të informimit dhe reagimit;
- Monitorimi i përparimit përmes grupit menaxhues.

Ky dokument strategjik nuk është parë të ketë nisur zbatimin as në Kaçanik dhe Han të Elezit, ku FIQ ka zhvilluar projektin për përmirësim të sigurisë në shkolla të mesme. Zyrtarët komunal, drejtorët e shkollave nuk kanë përmendur asnjëherë se kanë dijeni për ekzistimin e një strategjie për siguri, as ndonjë lidhje tjetër të nivelit komunal me Ministrinë e Arsimit lidhur me problemet e sigurisë në shkolla. Përveç reagimit pas ndonjë rasti apo incidenti brenda shkollave të tyre, ata nuk kanë patur ndonjë plan pune apo kornizë që do të përcaktonte veprimin e organizuar për të krijuar masa që do të evitonin rastet që cenojnë sigurinë në shkolla. Kjo ka bërë që ata të mirëpresin angazhimin e FIQ-it, duke e vlerësuar se një akter nga jashtë, cilido qoftë ai, u ofron mbështetje për të punuar në segmentin e sigurisë, i cili thjeshtë, nuk është pjesë e inkorporuar e veprimit të tyre institucional.

FIQ, duke përfunduar këtë projekt, është përpjekur që bashkë me anëtarët e zellshëm të Këshillave të lë pas një dokument të përbashkët orientues për Këshillat e shkollave. Ai dokument është produkt i gjithë procesit të punës, këshillimeve, ideve, diskutimeve për sfidat, dhe nismave që ishin theksuar në takimet disamuajshe. Dokumenti synon të lë një trup të organizuar që përdorë mundësitë dhe kapacitetet e veta për të vë në plan të punës përballjen me dukuritë që cenojnë sigurinë në shkollë.

Rekomandimet tona për zyrtarët arsimor, qeveritar, nxënësit dhe prindërit:

- Shkollat duhet të sigurojnë punë aktive të Këshillit të Shkollës, duke mundësuar kështu ushtrimin që i ka përcaktuar ligji në fuqi;
- Shkollat publike duhet të sigurojnë mekanizma përcjellës për të bërë të mundur zbatimin e plotë të “Kodit të Mirësjelljes”;
- Shkollat duhet të trajtojnë çështjen e sigurisë si pjesë të integruar të vetë procesit mësimor, duke siguruar kështu punë normale nëpër shkolla ku liria dhe siguria e nxënësve nuk do të cenohej;
- Është urgjente rritja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përkatëse: shkolla, Qendra për Punë Sociale, shërbimet korrektuese, policia, prokuroria, gjykata dhe prindërit.
- Institucionet qendrore duhet të rrisin investimet në infrastrukturën e shkollave dhe objekteve përcjellëse për të dëshmuar kështu përkushtim më të madh në fushën e arsimit;
- Institucionet qendrore përgjegjëse për hartim të politikave për shkollat publike duhet të sigurojnë pronësinë qytetare, e sidomos të atyre që përfshihen në zbatim të tyre, për të arritur kështu zbatim të suksesshëm të tyre;
- Përgjegjësit për shkollat e mesme duhet urgjentisht të vënë në zbatim rregulloren që kushtëzon pjesëmarrjen e prindit gjatë rexhistrimit të nxënësit, për të siguruar komunikimin e vazhdueshëm të prindërve me shkollën;
- Drejtorët dhe mësimdhënësit duhet të ndërtojnë marrëdhënie të qëndrueshme dhe të përhershme me Policinë e Kosovës për t'u dhënë përgjigje të gjitha rasteve të izoluara, e sidomos veprimeve jo ligjore që janë bërë dukuri e rrezikshme për shkollat tona;
- Drejtorët e shkollave duhet të përgatisin pakot e dokumenteve shitesë që prindi dhe nxënësi duhet t'i kuptojnë dhe nënshkruajnë gjatë rexhistrimit në shkollën e mesme: 1. Kodi i Mirësjelljes, 2. Formulari me informatat e prindit, 3. Formulari për deklaram të prindit se ka kuptuar të drejtat dhe obligimet për nxënësit dhe se zotohet se do të tregoj përkushtim për të marrë pjesë aktivisht në takimet konsultuese në shkollë;
- Shkollat në përgjithësi duhet të krijojnë kushte për kultivim të kulturës së debatit ndërmjet mësimdhënësve dhe nxënësve për të bërë të mundur zgjidhjen më të shpejtë dhe më të lehtë të problemeve të përditshmërisë së shkollave.